

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje karburanti” ndarë në 3 (tre) lote si më poshtë:

Loti 1 “Furnizim me lëndë djegëse diesel (Gazoil)”

Loti 2 “Furnizim me lëndë djegëse për automjete benzine pa plumb”

Loti 3 “Furnizim me lëndë djegëse e lëngët për përdorim termik civil dhe industrial (Mazut)”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP) :

Naftë 09134000-7

Benzinë 09132000-3

Karburante 09100000-0

VLERA E FONDIT LIMIT: Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 126,805,476.45 (njëqind e njëzet e gjashtë milion e tetëqind e pesë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e gjashtë pikë dyzet e pesë) lekë pa TVSH ose 1,277,894.55 (një milion e dyqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e katër pikë pesëdhjetë e pesë) Euro pa TVSH. e ndare ne 3 (tre) lote si me poshte:

Loti 1 “Furnizim me lëndë djegëse diesel (Gazoil)”, me fond limit 78,231,609.04 (shtatëdhjetë e tetë milion e dyqind e tridhjetë e një mijë e gjashtëqind e nëntë pikë zero katër) lekë pa TVSH ose **788,386.67** (shtatëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e treqind e tetëdhjetë e gjashtë pikë gjashtëdhjetë e shtatë) Euro pa TVSH

Loti 2 “Furnizim me lëndë djegëse për automjete benzine pa plumb”, me fond limit 4,993,867.41 (katër milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e shtatë pikë dyzet e një) lekë pa TVSH 50,326.18 (pesëdhjetë mijë e treqind e njëzet e gjashtë pikë tetëmbëdhjetë) euro pa TVSH

Loti 3 “Furnizim me lëndë djegëse e lëngët për përdorim termik civil dhe industrial (MAZUT)” me fond limit 43,580,000 (dyzet e tre milion e pesëqind e tetëdhjetë mijë) lekë pa TVSH ose 439,181.7 (katërqind e tridhjetë e nëntë mijë e njëqind e tetëdhjetë e një pikë shtatë) Euro pa TVSH

Kursi i këmbimit sipas Bankës se Shqiperise me datë 20.09.2024 eshte 99.23.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit

publik”, autoriteti/enti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Shtojca 7

Loti 1 “Furnizim me lëndë djegëse diesel (Gazoil)”

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit janë standarte dhe nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Referuar pikës 1 të shtojcës 7, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2, të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “*Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata*”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për të zbatuar me sukses kontratën siç është parashikuar nga AK.

Për sa i takon përcaktimit të vlerës së kërkuar ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të lotit që prokurohet, është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se “*Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar*”.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2021, 2022, 2023) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore që tregojnë raporte ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese.*

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 3, të ligjit me nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në nenin 43, pika 4 të VKM me nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në pikën 5 të nenit 61 të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, për paraqitjen e bilanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3Kapaciteti teknik:

2.3.1Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit të këtij loti**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose/dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për

miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimi, për realizimin e kontratës me sukses. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore etj, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2 Në mënyrë që të mbulohet shërbimi i ofrimit të karburantit me efikasitet dhe efektivitet pranë autoriteteve kontraktore, operatori ekonomik duhet të paraqesë listën e karburanteve në pronësi ose me qera ku minimumi duhet të ketë stacione të tregtimit me pakice të karburanteve:

- në bashkinë Tiranë të ketë të paktën 3 (tre) stacione të tregtimit me pakice të karburanteve sipas Tabelës nr.1;
- në bashkitë/njësitë administrative sipas tabelës nr 2 të ketë të paktën 5 (pese) stacione të tregtimit me pakicë të karburanteve
- në akset rrugore kryesore sipas tabelës nr 3 të ketë të paktën 5 (pesë) stacione të tregtimit me pakicë të karburanteve

Operatori ekonomik duhet të paraqesë listën e detajuar të stacioneve të shitjes së karburanteve me pakice sipas tabelës me poshtme me të dhenat perkatëse:

Tabela nr. 1 orientuese:

Nr	Bashkia Tiranë	Vendodhja (adresa)	Person kontakti
1	Tiranë Qëndër (Unaza e Vogël)		
2	Përgjatë Rrugës së Kavajës		
3	Përgjatë Rrugës së Durrësit		
4	Përgjatë rrugës “Dritan Hoxha”		
5	*Etj.....		

Tabela nr. 2 orientuese:

Nr	Bashkia/Njesia Administrative	Vendodhja(adresa)	Person kontakti
1	Tiranë		
2	Kukës		
3	Fier		
4	Etj...		

Tabela nr. 3 orientuese:

Nr	Aksi kombëtar	Vendodhja (adresa)	Person kontakti
1	Tiranë-Durrës		
2	Durrës-Fier		

3	Tiranë-Fushë Krujë		
4	Fushë Krujë-Kukës		
5	Etj....		

*Etj- Nënkupton të gjitha stacionet te shitjes se karburanteve me pakicë të tjera të cilat operatori ekonomik i disponon (në pronësi ose me qera).

***Shenim 3.1:**

Ne zbatim te Kodit Civil operatorët ekonomik te disponojne stacione te shitjes se karburanteve me pakice si me poshte:

- Ne pronesi dhe/ose te jene te pasqyruara ne ekstraktin e rregjistrimit tregtar leshuar nga QKB;
- kontrate noteriale qeraje ose furnizimi;

***Shenim 3.2:**

Për të gjitha stacionet e tregtimit me pakice te karburanteve duhet te paraqitet dokumentacioni si me poshte:

- Licencë leshuar nga pushteti vendor per tregtim karburantesh me pakice;
- Leje mjedisore perkatese leshuar nga QKL;
- Vertetim teknik leshuar nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK);
- Certifikate e mbrojtjes nga zjarri nga M.Z.SH;
- Police sigurimi ne nje nga shoqerite e sigurimeve qe operojne ne Shqiperi, te cilat duhet te jene brenda afatit te vlefshmerise daten e hapjes se ofertave;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM Nr. 970, datë 02.12.2015 ”Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregëtimin e naftës dhe nenprodukteve të saj”, të ndryshuar.

Vendosja e këtij kriteri nga ana e AK është bërë duke patur parasysh numrin e automjeteve të cilat duhet të furnizohen me karburant gjatë zbatimit të kontratës si dhe itineraret ditore që ato kryejnë në funksion të zbatimit të detyrave funksionale që ato kanë.

Në këtë procedurë prokurimi marrin pjesë disa autoritete kontraktore si p.sh Agjencia e Mbikqyrjes Policore, Drejtoria e Spitalit Rajonal Fier, Drejtoria e Përgjithsme e Arkivave, Prefekti i Qarkut Kukës etj, që ushtrojnë aktivitetin e tyre jo vetëm në Tiranë por në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Në vendosjen e një numri minimal prej 3 stacionesh tregtimi me pakice te karburanteve në Bashkinë e Tiranës është marrë parasysh madhësia e territorit të kësaj bashkie, si bashkia më e madhe në vend dhe numri i autoriteteve që e kane seline dhe operojnë kryesisht në kete bashki.

Në vendosjen e një numri minimal prej 5 stacionesh tregtimi me pakice te karburanteve në akset kryesore ndërlidhëse të vendit dhe minimalisht 5 të tilla në bashkitë/njësitë administrative është marrë parasysh mbulimi me shërbim të ofrimit të karburantit me efikasitet dhe efektivitet pranë autoriteteve kontraktore, qe jane pjese e kesaj procedure, duke patur parasysh shtrirjen e tyre gjeografike dhe territorin ku ushtrojnë veprimtarinë e tyre. Gjithashtu sjellim në vemendje se

pothuajse të gjitha autoritetet pjesëmarrëse në tender e ushtrojnë veprimtarinë e tyre edhe jashtë bashkive ku kanë selite perkatese, duke sjelle nevojën e pashmangshme për akses në furnizim në akset kryesore të vendit.

Për sa më lart, AK gjykon se kërkesa e mësipërme është plotësisht e argumentuar, në përputhje dhe në përputhje me objektin dhe natyrën e kontratës së prokurimit duke garantuar trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë dhe duke mos ngushtuar apo kufizuar konkurrencën.

Dokumentacioni për stacionet e tregimit me pakice të karburanteve është kërkuar sipas parashikimit të pikës II “*Procedura për dhënien e licencave për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëng-shëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga kon-sumatorët fundorë*” të VKM Nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregëtimin e naftës dhe nenprodukteve të saj”, i ndryshuar me ane të se cilit operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë liçencat profesionale si dhe dokumentacionin shoqërues, për furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, në kushtet kur kemi të bëjmë me furnizim me kartë, sipas kërkesës së disa Autoriteteve Kontraktore (referuar shtojcës 6 për lotin 1 “Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit”).

2.3.3 Flete analiza të lëshuar nga ISHTI për ato zëra të cilat është i akredituar, brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e hapjes së ofertave sipas standarteve në fuqi;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe nenit 40, pika 6, gërma c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, me anë të së cilit kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë për rezultatet zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike brenda një afati të arsyeshem.

2.3.4Subjekti ofertues duhet të paraqesë një vërtetim të lëshuar nga ISHTI, që vërteton se subjekti ofertues ka tregtuar karburante sipas standarteve të legjislacionit shqiptar dhe nuk ka patur penalitete për shkelje të cilesive përgjatë vitit 2024.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe nenit 40, pika 7, gërma c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar me anë të cilit kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se e ushtrojnë aktivitetin e tyre në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor duke mos patur penalitete përgjatë vitit 2024.

2.3.5 Subjekti ofertues duhet të paraqesë edhe deklaratat si mëposhte:

- Subjekti duhet të deklarojë, se merr përsipër furnizimin prane stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë me shërbim 24 orë me kartë elektronike të personalizuar me targën e cdo automjeti të autoritetit kontraktor, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.
- Subjekti duhet të deklarojë se merr përsipër furnizimin me karburant detyrimisht me pistoletë publike.
- Operatori ekonomik duhet të mbulojë furnizimin nepermjet kartave elektronike të personalizuar, sipas adresave të kerkuara nga Autoritetit Kontraktor.
- Bazuar ne VKM Nr 561 date 29.07.2016 “**Per Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve te karburantit ne njesite e qeverisjes se pergjithshem**“, Operatoret ekonomik pjesemarres duhet te ofrojne nje faqe menaxhimi te karburanteve (web page), ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit per mjetet efektive te transportit te kryhet nepermjet kartës elektronike.
- Faqja e menaxhimit te karburanteve (webpage) duhet të ofrojë shërbimin e ngarkimit te sasisë se karburantit nga Operatori ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor, me qëllim qe rimbushja e kartave elektronike te personalizuar me targën e mjetit, si dhe administrimi i sasise se karburanteve te kryhet nga vet AK. Nderfaqja duhet te ofroje edhe mundesine e afishimit si dhe administrimi i sasise se karburanteve te kryhet nga vet Autoriteti kontraktor.
- Faqja e menaxhimit te karburanteve duhet te ofroje edhe sherbimin per krijimin e struktures piramidale ne perputhje me strukturen piramidale te Autoritetit kontraktor, sherbimin e furnizimit me karburant nepermjet kartave elektronike në formën e stikerave (pullave), te cilat ngjiten ne xhamin e automjetit dhe ofrojne sherbimin e furnizimit me karburant vetem per ate automjet per te eliminuar levizjen e mundshme te targave nga mjetit shteteror drejt mjeteve private, si dhe sherbimin e dergimit te fotografive me ane te emailit per cdo furnizim te kryer te mjetit prane stacionit te shitjes se karburanteve me pakice me qëllim identifikimin e mjetit dhe perdoruesit te saj .
- Mos ofrimi i sherbimeve te kerkuara me siper ne menyre elektronike nepermjet Faqes se menaxhimit te karburanteve (webpage), qe ofron cdo operator ekonomik pjesemarres perben kusht per s’kualifikim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar dhe nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, te ndryshuar, me ane te se cilit operatori ekonomik vetedeklaron duke ofruar garanci per AK se furnizimi do te realizohet me karta elektronike sipas kerkesave te parashikuara me lart.

Shtojca 7

Loti 2 “Furnizim me lëndë djegëse për automjete benzine pa plumb”

FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1.KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Referuar pikës 1 të shtojcës 7, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të lotit. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 43, pika 2/c dhe nenin 55, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2, të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “*Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata*”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për të zbatuar me sukses kontratën siç është parashikuar nga AK.

Për sa i takon përcaktimit të vlerës së kërkuar prej jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se “*Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar*”.

2.3Kapaciteti teknik:

2.3.1Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit të këtij loti**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose/dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 55, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit, për realizimin e kontratës me sukses. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore etj, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2Në mënyrë që të mbulohet shërbimi i ofrimit të karburantit me efikasitet dhe efektivitet pranë autoriteteve kontraktore, operatori ekonomik duhet të ketë te paraqes listën e karburanteve në pronësi ose me qera ku minimumi duhet të ketë stacion te tregtimit me pakice te karburanteve:

- në bashkinë Tiranë të ketë të paktën 3 (tre) stacione te tregtimit me pakice te karburanteve sipas Tabelës nr.1;
- Në bashkitë/njësitë administrative sipas tabelës nr 2 të ketë të paktën në 5 (pesë) stacion të tregtimit me pakicë të karburanteve

- Në akset rrugore kryesore sipas tabelës nr 3 të ketë të paktën 5 (pesë) stacione të tregimit me pakicë të karburanteve

Operatori ekonomik duhet të paraqes listen e detajuar të stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë sipas tabelës me poshteme me të dhënat përkatëse:

Tabela nr. 1 orientuese:

Nr	Bashkia Tiranë	Vendodhja (adresa)	Person kontakti
1	Tiranë Qëndër (Unaza e Vogël)		
2	Përgjatë Rrugës së Elbasanit		
3	Përgjatë Rrugës së Kavajës		
4	Përgjatë Rrugës së Durrësit		
5	Përgjatë Rrugës së Dibres		
6	Etj.....		

Tabela nr. 2 orientuese:

Nr	Bashkia/Njesia Administrative	Vendodhja (adresa)	Person kontakti
1	Lushnje		
2	Etj.....		

Tabela nr. 3 orientuese:

Nr	Aksi kombëtar	Vendodhja (adresa)	Person kontakti
1	Tiranë-Durrës		
2	Tiranë-Krujë		
3	Krujë- Mat		
4	Etj.....		

*Etj- Nënkupton të gjitha stacionet të shitjes së karburanteve me pakicë të tjera të cilat operatori ekonomik i disponon (në pronësi ose me qera)

Shenim 3.1:

Ne zbatim të Kodit Civil operatorët ekonomik të disponojnë stacione të shitjes së karburanteve me pakicë si me poshte:

- Ne pronësi dhe/ose të jenë të pasqyruara në ekstraktin e regjistrimit tregtar leshuar nga QKB;
- kontrate noteriale qeraje ose furnizimi;

***Shenim 3.2:**

Për të gjitha stacionet e tregimit me pakicë të karburanteve duhet të paraqitet dokumentacioni si me poshte:

- Licence leshuar nga pushteti vendor per tregtim karburantesh me pakice;
- Leje mjedisore perkatese leshuar nga QKL;
- Vertetim teknik leshuar nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK);
- Certifikate e mbrotjes nga zjarri nga M.Z.SH;
- Police sigurimi ne nje nga shoqerite e sigurimeve qe operojne ne Shqiperi, te cilat duhet te jene brenda afatit te vlefshmerise daten e hapjes se ofertave;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM Nr. 970, datë 02.12.2015 ”Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregëtimin e naftës dhe nenprodukteve të saj”, të ndryshuar.

Vendosja e këtij kriteri nga ana e AK është bërë duke patur parasysh numrin e automjeteve të cilat duhet të furnizohen me karburant gjatë zbatimit të kontratës si dhe itineraret ditore që ato kryejnë në funksion të zbatimit të detyrave funksionale që ato kanë.

Në këtë procedurë prokurimi marrin pjesë dy autoritete kontraktore, ku njeri prej tyre është Agjencia e Mbikqyrjes Policore, që ushtron aktivitetin e saj jo vetëm në Tiranë por në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe numri minimal prej 3 stacionesh tregëtimi me pakice të karburanteve në Bashkinë e Tiranës është vendosur duke marrë parasysh madhësia e territorit të kësaj bashkie, si bashkia më e madhe në vend si dhe nevojën që ka ministria si një institucion me shume mjete dhe kërkesa të larta për akses në pika karburanti.

Në vendosjen e një numri minimal prej 5 stacionesh tregëtimi me pakice të karburanteve në akset kryesore ndërlidhëse të vendit dhe minimalisht 5 të tilla në territorin e bashkive/njësite administrative është marrë parasysh mbulimi me shërbim të ofrimit të karburantit me efikasitet dhe efektivitet pranë autoriteteve kontraktore, që janë pjesë e kësaj procedure, duke patur parasysh shtrirjen e tyre gjeografike dhe territorin ku ushtrojnë veprimtarinë e tyre. Gjithashtu sjellim në vëmendje se pothuajse të gjitha autoritetet pjesëmarrëse në tender e ushtrojnë veprimtarinë e tyre edhe jashtë bashkive ku kanë selite perkatese, duke sjelle nevojën e pashmangshme për akses në furnizim në akset kryesore të vendit.

Për sa me lart, AK gjykon se kërkesa e mësipërme është plotësisht e argumentuar, në përputhje dhe në përputhje me objektin dhe natyrën e kontratës së prokurimit duke garantuar trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë dhe duke mos ngushtuar apo kufizuar konkurrencën.

Dokumentacioni për stacionet e tregëtimin me pakice të karburanteve është kërkuar sipas parashikimit të pikes II “Procedura për dhënien e licencave për tregëtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëng-shëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga kon-sumatorët fundorë” të VKM Nr. 970, datë 02.12.2015 ”Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregëtimin e naftës dhe nenprodukteve të saj”, i ndryshuar me ane të se cilit operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë liçencat profesionale si dhe dokumentacionin shoqërues, për furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, në kushtet kur kemi të bëjmë me furnizim me kartë, sipas kërkesës së disa Autoriteteve Kontraktore (referuar shtojcës 6 për lotin 2 ”Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimin”).

2.3.3 Flete analiza të lëshuar nga ISHTI për ato zëra të cilat është i akredituar, brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e hapjes së ofertave sipas standarteve ne fuqi;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar dhe nenit 40, pika 6, gërma c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, te ndryshuar, me anë të së cilit kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë për rezultatet zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuara, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike brenda një afati të arsyeshëm.

2.3.4 Subjekti ofertues duhet të paraqese nje vertetim te leshuar nga ISHTI, qe vërteton se subjekti ofertues ka tregtuar karburante sipas standarteve te legjislacionit Shqiptar dhe nuk ka patur penalitete per shkelje te cilesise pergjatë vitit 2024.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar dhe nenit 40, pika 7, gërma c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, te ndryshuar me anë të cilit kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se e ushtrojnë aktivitetin e tyre në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor duke mos patur penalitete pergjate vitit 2024.

2.3.5 Subjekti ofertues duhet të paraqesë edhe deklaratat si meposhte:

- Subjekti duhet të deklarojë, se merr përsipër furnizimin prane stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë me shërbim 24 orë me kartë elektronike te personalizuar me targen e cdo automjeti te autoritetit kontraktor, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.
- Subjekti duhet të deklarojë se merr përsiper furnizimin me karburant detyrimisht me pistoletë publike.
- Operatori ekonomik duhet te mbuloje furnizimin nepermjet kartëve elektronike te personalizuara, sipas adresave te kerkuara nga Autoritetit Kontraktor.
- Bazuar ne VKM Nr 561 date 29.07.2016 “**Per Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve te karburantit ne njesite e qeverisjes se pergjithshem**“, Operoret ekonomik pjesemarres duhet te ofrojne nje faqe menaxhimi te karburanteve (ëebpage), ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit per mjetet efektive te transportit te kryhet nepermjet kartës elektronike.
- Faqja e menaxhimit te karburanteve (ëebpage) duhet të ofrojë shërbimin e ngarkimit te sasisë se karburantit nga Operatori ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor, me qellim qe rimbushja e kartave elektronike te personalizuar me targen e mjetit, si dhe administrimi i sasise se karburanteve te kryhet nga vet AK. Nderfaqja duhet te ofroje edhe mundesine e afishimit si dhe administrimi i sasise se karburanteve te kryhet nga vet Autoriteti kontraktor.
- Faqja e menaxhimit te karburanteve duhet te ofroje edhe sherbimin per krijimin e struktures piramidale ne perputhje me strukturen piramidale te Autoritetit kontraktor, sherbimin e furnizimit me karburant nepermjet kartave elektronike në formën e stikerave (pullave), te cilat ngjiten ne xhamin e automjetit dhe ofrojne sherbimin e furnizimit me karburant vetem per ate automjet per te eliminuar levizjen e mundshme te targave nga mjetit shtetor drejt mjeteve private, si dhe sherbimin e dergimit te fotografive me ane te emailit per cdo furnizim te kryer te mjetit prane stacionit te shitjes se karburanteve me pakice me qellim identifikimin e mjetit dhe perdoruesit te saj .

- Mos ofrimi i sherbimeve te kerkuara mesiper ne menyre elektronike nepermjet Faqes se menaxhimit te karburanteve (webpage), qe ofron cdo operator ekonomik pjesemarres perben kusht per skualifikim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar dhe nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, te ndryshuar, me ane te se cilit operatori ekonomik vetedeklaron duke ofruar garanci per AK se furnizimi do te realizohet me karta elektronike sipas kerkesave te parashikuara me lart.

Shtojca 7

Për Lotin 3 “Furnizim me lëndë djegëse e lëngët për përdorim termik civil dhe industrial (Mazut)”

FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1.KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*
- Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1Operatori Ekonomik duhet të paraqesë licencën përkatëse për tregtimin me shumicë të lendes djegese, objekt prokurimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 2 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 40, pika 5, gërma a) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, në zbatim të ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999 ”Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, të VKM Nr. 970, datë 02.12.2015 ”Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregëtimin e naftës dhe nënprodukteve të saj”, i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencen profesionale për furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuar nga autoritetet kompetente shtetërore, ne kushtet kur kemi te bëjmë me furnizim me bot, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor Perfitues .

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2, të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “*Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata*”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpermjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për të zbatuar me sukses kontratën siç është parashikuar nga AK.

Për sa i takon përcaktimit të vlerës së kërkuar ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të lotit që prokurohet, është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se “*Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar*”.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2021, 2022, 2023) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 3, të ligjit me nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në nenin 43, pika 4 të VKM me nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në pikën 5 të nenit 61 të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, për paraqitjen e bilanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3Kapaciteti teknik:

2.3.1Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit të këtij loti**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose/dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.
- b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimi, për realizimin e kontratës me sukses. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore etj, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2Flete analiza të lëshuar nga ISHTI për ato zëra të cilat është i akredituar, brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e hapjes së ofertave sipas standarteve në fuqi;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe nenit 40, pika 6, gërma c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, me anë të së cilit kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë për rezultatet zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike brenda një afati të arsyeshem.

2.3.3Subjekti ofertues duhet të paraqesë një vërtetim të lëshuar nga ISHTI, që vërteton se subjekti ofertues ka tregtuar karburante sipas standarteve të legjislacionit shqiptar dhe nuk ka patur penalitete për shkelje të cilesive përgjatë vitit 2024.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe nenit 40, pika 7, gërma c) të VKM nr.

285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, te ndryshuar me anë të cilit kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se e ushtrojnë aktivitetin e tyre në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor duke mos patur penalitete pergjate vitit 2024.

2.3.4Operatori ekonomik duhet te paraqese Vërtetim teknik te leshuar nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK), Leje mjedisore te tipit B, te leshuar nga QKL, Akt-Teknik te leshuar nga PMNZH, dhe Police Sigurimi lëshuar nga shoqerite e sigurimeve qe operojne ne Shqiperi, për depozitat e tregimit qe vërteton kapacitetet depozituese minimalisht 500 m³ lidhur me rezervat e operatorit ekonomik, per te garantuar vazhdimesi ne furnizim, sipas kerkesave te autoritetit kontraktore.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, në zbatim të ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999 ”Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, të VKM Nr. 970, datë 02.12.2015 ”Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregëtimin e naftës dhe nënprodukteve të saj”, i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë kapacitete teknike me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses dhe për të garantuar vazhdimësi në furnizim, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

Dokumentacioni i siperpermendur eshte kerkuar sipas parashikimit te pikes III “*Kushtet për pajisjen me licencë të tregimit me shumicë të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj*” të VKM Nr. 970, datë 02.12.2015 ”Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregëtimin e naftës dhe nënprodukteve të saj”, i ndryshuar, me ane te se cilit operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë dokumentacionin perkatës dhe kapacitetin minimal te depozitave prej 500 m³ , kapacitet i cili eshte kusht per pajisjen me licence tregtimi nga autoritetet kompetente shtetërore, per kategorie V B, Mazut

Per sa me lart, AK gjykon se kërkesa e mësipërme është plotësisht e argumentuar, në përputhje dhe në përputhje me objektin dhe natyrën e kontratës së prokurimit duke garantuar trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë dhe duke mos ngushtuar apo kufizuar konkurrencën.

2.3.5Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të disponojë të paktën 1 (një) autobot/ autocisternë me kapacitet mbajtës minimalisht 5 000 litra, të cilin mund ta ketë në pronësi ose me qira.

Per sa me siper operatori ekonomik te paraqes nje deklarate perkatese sipas formatit te meposhtem:

Nr.	Lloji i mjetit	Targa	Kapaciteti mbajtes	Statusi
1				Pronesi/qira/perdorim
2				Pronesi/qira/perdorim

Shënim:

Per mjetet me status perdorimi qira/hua perdorje te disponohet kontrata noteriale perkatese mes qiradhenesit dhe qiramarresit.

Për këtë mjet duhet të paraqesi librezë qarkullimi, akt kolaudimi, sigurimin e detyrueshëm të mjeteve, çertifikaten per transportin e lendeve te rrezikshme dhe pashaporten e mjetit per kapacitetin mbajtes ne litra.

Ky kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rast se OE kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar dhe nenit 40, pika 5, gërma ç) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, te ndryshuar, *me anë të* se cilit kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Konkretisht, shërbimi i furnizimit me bot eshte kerkuar nga autoriteti kontraktor dhe disponimi i nje mjeti te tille me kapacitet minimal prej 5000 litrash eshte plotesisht i argumentuar dhe ne proporcion me natyren e kontrates.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë në bazë të së cilës merr persiper furnizimin me lëndë djegëse me autobotin/ autocisternën e tij dhe shpenzimet e tij deri në vendin ku ndodhen depozitat e autoritetit kontraktor duke zbatuar të gjitha dispozitat ligjore për transportin e lëndëve djegëse.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar dhe nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, te ndryshuar, me ane te se cilit operatori ekonomik vetedeklaron duke ofruar garanci per AK se furnizimi do te realizohet me bot sipas kerkesave te parashikuara me lart.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga Autoritetet Kontraktore referuar katalogut të standarteve “Blerje karburanti, me perjashtim te vajgurit, Jet A1 dhe karburantit që prokurohet nga fermerët”, bashkëlidhur procedurës së prokurimit.

Standartet e paraqitura në katalogun e sipercituar janë standarte të blera nga ana e Organit Qendror Bleres prej Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit (DPS) si Organi Kombëtar i Standardizimit në Republikën e Shqipërisë. Nga komunikimi shkresor që kemi patur me DPS-ne, ka sqaruar se ka detyrimin të adoptojë si standarte shqiptare (SSH) standartet europiane në mënyrë identike dhe pa ndryshime në tekstin origjinal. Si rrjedhim, referencat e normativave në përmbajtje të standartit janë pjesë e tekstit origjinal të standarteve të huaja dhe për këtë arsye nuk ka të drejtë të bëjë ndryshime.

Per sa me lart, duke qene se Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit nuk ka të drejtë të bëjë

ndryshime ne brendesi te standarteve qe shet, as Organi Qendror Bleres ne rolin e bleresit nuk ka te drejte te beje ndryshime.

Ne keto kushte sqarojme se per cdo standart te permendur ne brendesi te cdo standarti kryesor lejohet paraqitja e ekuivalentit te tij, qofte ai dhe Standarti Shqiptar (SSH).

NJËSIA E PROKURIMIT